



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1982 prot.

Shkodër, më 03.08. 2026

**VENDIM
Nr. 58, datë 29.07.2026**

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
PASURISË NR. 316, VOL. 6, FQ. 48, ZK 1209, NGA PRONËSIA SHTETËRORE
NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 29.07.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 8, pika 2, dhe nenin 9, pika 1.2, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; në nenin 3, shkronja "a", nenin 5 dhe nenin 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar; në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 500, datë 14.08.2001, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar; në Udhëzimin nr. 15, datë 30.06.2003, "Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike", si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për transferimin në pronësi të Bashkisë Shkodër të pasurisë me të dhënat si më poshtë:
 - o Pasuria nr. 316, vol. 6, fq. 48, Zona Kadastrale nr. 1209, Shkodër, me sipërfaqe të përgjithshme 1 959 910 m², e cila, referuar kartelës së pasurisë, rezulton në pronësi të shtetit.
2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi do të përdoret për kryerjen e funksioneve kulturore dhe sportive.
3. Të ndiqen procedurat përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për transferimin e pronësisë së pasurisë së sipërcituar, duke bashkërenduar punën me institucionet përgjegjëse.


4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Miraturar me 36 vota

Vota Pro	36
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	30.07.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion LULLI



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI : SHTET

DATE : 17 / 07 / 2026

QELLIMI : RREGJISTRIM

VENDNDODHJA

BASHKIA : SHKODER

DVASHK/ZVASHK : SHKODER

ZONA KADASTRALE : 1209

NUMRI PASURISE : 316

INDEX HARTE : K-34-64(210-A,194-A,178-C

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI I PASURISE : XX

SIP.PASURISE = 11959910 m2


SIP. GJURMES NDERTIMIT =

NUMRI I KATEVE :

VL. 6

FQ. 48

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SHPJEGUES

PER NDARJE PASURIE

Parcela 1= m2

Parcela 2= m2

Parcela 3= m2

PER BASHKIM PASURIE

Parcela 1= m2

Parcela 2= m2

Parcela 3= m2

KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE

SUPERFAQE= m2

KUFIRI SIPAS GJENDJES FAKTKE

SUPERFAQE= m2

SH:

ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
VERI					
LINDJE					
JUGU					
PERENDIMI					

DREJTORIA ASETVE DHE KADASTRES URBANE

DREJTORI: VALDO DIBRA

PUNOI. SPECIALISTI : ARJAN VASIJA

NENSHKRIMI / VULA

REALIZOI PER ASHK

DVASHK

SPECIALISTI

NENSHKRIMI

KONFIRMOI

PERGJEGJEGJESI / DREJTORI

NENSHKRIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:

Kode per teknologji e matjeve: T-Terren; z-zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-matje Distancash;

PERCAKTIMI I KUFIRIT:

Kode per percaktimin e kufirit; P-Perfaqesues i Pronave ; K-Kufitaret te Gjithe ; KP-Kufitaret Pjeserisht ; PB-Perfaqesues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI / BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI: BASHKIA SHKODER

NENSHKRIMI

Kode per teknologji e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; z-zyre;o-Ortofoto;G-GPS; S-Stacion Total; d-matje D-Matje Distancash; p-Perfaqesues i Pronave; k-kufitaret te Gjithe; KP-Kufitaret Pjeserisht; PB- Perfaqesues Bashkie, HK- Harta Kadastrale

